



Planuar / Ditezuar Propozuar / Propozuar Reviewed / Delivered	16.05.2022	2	DATE DATE DATE
Organ / Bërsa Organ / Jedinstvo Org / Unit	Pr. Prof. Pr. Prof. Prof. Dr.	Shërbim Prisec Zemërime	Bërsa Kohëzma Durimty
SRM/SHK	2842/2022		113



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

**A.nr.335/2022**

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca anëtarë, me Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.335/2022 të datës 06.04.2022 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit Komuna e Gjakovës, në çështjen juridike-administrative "kërkesë nga marrëdhënia e punës-transferim për shkak të ristrukturimit", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 16.05.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën A.nr.335/2022 të datës 06.04.2022, të parashtruar nga ankuesi

**A r s y e t i m**

Ankuesi i punësuar në Komunën e Gjakovës, më datë 06.04.2022 ka parashtruar ankesën me numër protokoll 1900/2022 e regjistruar me shenjën A.nr.335/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit 01-112/02-8064 të datës 31.03.2022 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore për shkak të shkeljes së ligjit material dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullore Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 12.04.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Gjakovës, ndërsa kjo e fundit me datë 20.04.2022 ka përcjell përgjigjen në ankesë me numër protokoll 2239/2022 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 06.04.2022 me numër protokollit 1900/2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin Nr.01-112/02-8064 të datës 31.03.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore lidhur me transferimin e nëpunësit Civil; Fletë lëshimin me numër amëz 1173 të datës 07.03.2022; Akt emërimit me numër 01 112-143/28 të datës 12.03.2012; Fletë lëshimin me numër 952 të datës 23.02.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 2020/2022 të datës 12.04.2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 2239/2022 të datës 20.04.2022; Vendimin me numër 01-112/02-6281 të datës 15.03.2022; Emalin e datës 15.03.2022; Emalin e datës 15.03.2022; Fletë dorëzimit me numër 01-112/02-6281 të datës 16.03.2022; Vendimin me numër 01-112/02-6886 të datës 21.03.2022; Emalin e datës 21.03.2022; Emalin e datës 23.03.2022; Propozimin me numër 01-112/02-7590 të datës 28.03.2022; Vendimin Nr. 01-112/02-8064 të datës 31.03.2022; Emalin zyrtar të datës 31.03.2022; Emalin zyrtar me numër të protokollit 2763/2022 të datës 12.05.2022; Vendimin me numër 01/112/02-24795/21 të datës 30.08.2021; Vendimin me numër 01-112/02-34098 të datës 09.11.2021; Vendimin me numër 01-112/02-24809/21; Vendimin me numër 01/112/02-24795/21 të datës 30.08.2021; Vendimin me numër 01-112/02-34098 të datës 09.11.2021; Vendimin me numër 01-112/02-24809/21 të datës 30.08.2021; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Kurir; Emalin zyrtar me numër të protokollit 2768/2022 të datës 12.05.2022 të bashkangjitur edhe tabelën lidhur me verifikimin e statusit të Zyrtarëve Publik të Komunës së Gjakovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovë nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi *sepse:*

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rezulton se ankuesi është i punësuar në Komunën e Gjakovës, dhe së i njëjti sipas Akt emërimit me numër 01 112/143/28 të datës 29.02.2012 është emëruar *Kurir i Zyrës së vendit Danjan* në kuadër të Drejtorisë për Punë të Përgjithshme Administrative.

Me tej Kolegji nga analizimi i provat materiale lidhur më çështjen në procedurë vëren se me Vendimin Nr. 01-112/02-6281 të datës 15.03.2022 të Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore, është vendosur për ristrukturimin e Sektorit të Gjendjes Civile dhe Sektorit për Inspektime, me arsyetimin se në Sektorin e Gjendjes Civile janë katër (4) nëpunës me pozitë të korrierit e të cilit nuk janë të nevojshme në këtë sektor, ndërsa sa i për këtë Sektorit për Inspektime në vitin 2021 të gjithë inspektorët sanitarë në kuadër të Komunës së Gjakovës janë bartur në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës sipas transferimit të bërë në të gjitha komunitat. Si pasojë e këtij ristrukturimi Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore me Vendimin Nr. 01-112/02-6886 të datës 21.03.2022, ka themeluar Komisionin e ristrukturimit në përbërje nga tre anëtarë, i cili me Propozimin Nr.01-112/02-7590 të datës 28.03.2022 ka propozuar transferimin e ankuesit nga pozita *Kurir* në pozitën *Zyrtar për Telefoni në kuadër Sektorin për Siguri dhe Emergjencë*, e komform këtij propozimi Menaxheri i Burimeve Njerëzore me Vendimin me Nr. 01-112/02-8064 të datës 31.03.2022, ka transferuar anketuesin nga pozita *Kurir* në pozitën *Zyrtar për Telefoni në kuadër Sektorit për Siguri dhe Emergjencë*.

Kolegji bazuar në listën e verifikimit të statusit nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, pozita e ankuesit *kurir* është kategorizuar si



pozitë e nëpunës administrativ dhe mbështetës, kështu qe nisur nga ky fakt dhe në kuptim të dispozitave të nenit 2 paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilat është përcaktuar se: *Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike,* dhe meqenëse objekti i vet ankesës së ankuesit ka të bëjë me pretendimin që të kthehet në pozitën Kurir e cila nuk hyn në kategorinë e nëpunësve civil, kështu që bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.335/2022 të datës 06.04.2022, të parashtruar nga ankuesi

Bazuar në rrethanat si me lartë, e në kuptim të dispozitave të nenit 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nëpunësi administrativ dhe mbështetës ka të drejtë të ankohet të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.335/2022

Ilire Mehmeti-Shaqiri

*Ilire Mehmeti-Shaqiri*  
Procesmbajtëse



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Gjakovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Gjakovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

